



ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

Broshurë,
3-mujori i parë,
2022

Përgjegjësia Sociale e Korporatave

Janar - Mars 2022



abi AMERICAN BANK OF INVESTMENTS

- Mbështeti edicionin e parë të Fem – Fest në Shqipëri, i cili u zhvillua nga data 5 - 8 mars. I pari i këtij lloji, festivali synoi ndërgjegjësimin e opinionit publik për të drejtat e grave.
- Mbështeti edicionin e 18-të të Festivalit Ndërkombëtar të Vokalit Operistik “Marie Kraja”, në datat 29 -30 mars në Teatrin Kombëtar të Operës dhe Baletit.







BKT

- Në bashkëpunim me Bashkinë Elbasan, me rastin e Ditës së Verës, mbështeti financiarisht projektin “Java e Verës Elbasan 2022”. Ky projekt promovon zonën dhe vlerat e saj kulturore.
- Në përgjigje të kërkesës së Zyrës Arsimore Kamzë, mbështeti institucionin në përmirësimin e kushteve të punës.
- Mbështeti financiarisht aktivitetin Kampionati i Basketbollit të organizuar nga Shoqata Sportive Galaktikking.
- Në Javën e Parasë, vlerësoi dhe mbështeti financiarisht konkursin e esesë më të mirë me temë “Banka digjitale dhe ndikimi i saj në rritjen e përfshirjes financiare”. Banka vlerësoi 5 esetë fituese dhe shpërndau për fituesit tabletë si dhe mundësoi praktikë mësimore 3-mujore në BKT.

- Global Finance shpalli çmimet për të 29-in vit radhazi për bankat më të mira në Evropën Qendrore dhe Lindore për vitin 2022. Revista Global Finance vlerëson Bankën Kombëtare Tregtare me çmimin “Banka më e mirë në Shqipëri për vitin 2022”. Ky çmim i marrë nga kjo revistë prestigjioze thekson vlerësimin e saj ndër vite ndaj BKT.

CREDINS bank

- Mbështeti Food Bank përgjatë muajit shkurt. U shpërndanë 60 pako ushqimore në familje të qytetit të Gjirokastrës.
- Mbështeti Akseleratorin Uplift Albania 2021 përgjatë gjithë kohëzgjatjes si dhe mori pjesë në eventin e finales Demo Day.
- Mbështeti Tirana Inc, me pjesëmarrjen e studentëve të disa universiteteve në Tiranë të cilët dhanë idetë e tyre novatore për startup-e në fusha të ndryshme, me partnerë ndërkombëtarë, si: EU for Innovation, Preneurz Amsterdam, GIZ.
- Dhuroi libra për nxënësit e shkollës së mesme të bashkuar artistike “Ajet Xhindole”. Dhurimi u organizua përgjatë koncertit pianistik “Nën tingujt klasikë të pianisteve të rinj”, i cili u zhvillua për herë të parë në Qendrën Kulturore “Margarita Tutulani”, Berat.
- Dhuroi kompjuterë dhe pajisje



- të tjera zyre për shkollën 9-vjeçare “Kolë Koçi”, Zyra Vendore Arsimore Pogradec; Zyrën Vendore Arsimore Kamzë dhe Zyrën Vendore Arsimore të Tiranës (Shkolla 9-vjeçare “Hasan Tahsimi”).
- Dhuroi pajisje zyre për FSDKSH Lezhë dhe për Qendrën Shëndetësore Nr. 3 Berat.
 - Mori pjesë në “Panairin e Punës Syn+Ergasia”, i cili u zhvillua në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë, Ambasadën e Greqisë në Tiranë si dhe Hellenic Business Association of Albania; si dhe në Panairin e punës “Work and Study”.
 - Mbështeti konkursin “Colours of Albanians”, i cili ka në fokus promovimin talenteve në fushën e fotografisë, si dhe të vendeve të bukura të vendit tonë. Një organizim nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme e Shqipërisë si dhe Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës e Kosovës, nga ku dolën dhe 6 fitues në ditën e pavarësisë së Kosovës.
 - Dhuroi kontribut në festivalin Twinkle Twinkle, një konkurs kënge për fëmijë.
 - Mirëpriti ekspozitën e piktorit Admir Përvathi i cili solli në fokus ekspresionizmin abstrakt nëpërmjet pikturave të tij. Shndërrimi i ambienteve të degës qendrore në një ekspozitë arti është kthyer tashmë në një traditë të bukur.
 - Kontribuoi në mbarëvajtjen Ditës së Miqësisë së Gazetarëve Shqiptarë, organizuar në

qytetin e Prishtinës.

- Mori pjesë në Maratonë Malore, zhvilluar këtë vit në Petrelë.
- Mbështeti klubin sportiv Studenti. Gjithashtu, mbështeti Kampionatin e Taekwondo; si dhe Federatën Shqiptare të Sportit Universitar në organizimin e Kampionatit të Tenisit.
- Mbështeti koncertin e këngëtarit Maluma, një ndër artistët më të famshëm të tregut botëror. Koncerti u organizuar në 14 Mars për ditën e verës.
- Në bashkëpunim me Shoqatën Shqiptare të Bankave, në Javën e Parasë, Credins Bank mbështeti konkursin e videos më të mirë me tematikë “Tregohu i zgjuar me paranë, ndërto të ardhmen tënde”. Banka ishte pjesë e leksioneve Bankingu Digjital, ku stafi mbajti një trajnim për bankingun digjital në Universitetin European të Tiranës.



- Fibank mbështeti Federatën Shqiptare të Skive në zhvillimin e sportit të skive në zonat Shishtavec, Borje dhe Pukë. Në ceremoninë e organizuar me këtë rast ishin të pranishëm ambasadori i Bullgarisë në Tiranë z. Momtchil Raytchevski, Drejtori i Përgjithshëm i Fibank, z. Bozhidar Todorov,



Presidenti i Komitetit Olimpik për Shqipërinë z. Fidel Ylli dhe Presidenti i Federatës Shqiptare të Skive, z. Elvis Toci.

- Dita Ndërkombëtare e Gruas, 8 mars, është gjithashtu një referencë kryesore për lëvizjen për të drejtat e grave, duke sjellë në vëmendje çështje si barazia gjinore, të drejtat riprodhuese, etj. Tashmë 74% e stafit në Fibank janë femra. Këtë vit, Fibank i kushtoi një dhuratë të veçantë çdo klienti të parë të gjinisë femërore në degët e bankës.
- I gjithë stafi Fibank, në bashkëpunim me Digital Academy Albania, zhvilloi një trajnim transformues mbi rritjen e prezencës & komunikimit digjital dhe strategjive për të edukuar më shumë klientë, krijuar marrëdhënie efektive me ta, dhe gjeneruar vazhdimisht shitje.



Banka i ka kushtuar rëndësi të veçantë dhe ka promovuar:


- Ditën Ndërkombëtare të Arsimit, 24 janar. Përgjatë viteve, banka ka ndërmarrë projekte të ndryshme si "Arti i Kursimit", gjatë të cilit pjesëtarë të stafit në mënyrë vullnetare dhanë mësim në bankat e shkollave nëntëvjeçare.
- Ditën Ndërkombëtare të Vëllazërisë Njerëzore, 4 shkurt. Banka synon të krijojë edhe

më shumë hapësira për të gjitha gratë e talentuara në fusha të ndryshme të shkencës nëpërmjet vendeve të reja të punës si edhe produkteve të dedikuara për zhvillimin e tyre profesional.

- Ditën Botërore të Drejtësisë Sociale, 20 shkurt.
- Ditën e Zero Diskriminimit, 1 mars.
- Ditën Botërore të Kafshëve të Egra, 3 mars.
- Ditën Ndërkombëtare të Gruas:
 - » 75% e stafit menaxherial që raporton në mënyrë hierarkike te Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i ISP Albania janë gra dhe vajza.
 - » 71% e stafit të ISBA-së janë gra dhe vajza dhe pjesëmarrja e tyre në komitetet e bankës është 50%.
- Ditën Botërore të Sindromës Down, 21 mars.
- Ditën Ndërkombëtare Kundër Diskriminimit Racial, 21 mars.
- Ditën Botërore të Ujit, 22 mars.
- Ditën Botërore të Meteorologjisë, 23 mars.

Në kuadër të Javës Globale të Parasë, banka organizoi disa leksione të hapura:

- Në 25 mars, z. Alessandro D'Oria, Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, dhe z. Julian Çela, Drejtor i Përgjithshëm Financiar në Intesa Sanpaolo Bank Albania, vizituan ambientet e universitetit Epoka, në Tiranë. Pjesë e kësaj vizite, ishte



mbajtja e një leksioni të hapur me 100 studentë të fakultetit të ekonomisë dhe shkencave administrative, mbi temën e buxhetimit dhe pasqyrave financiare.


- Në 24 mars, znj. Xhilda Shehu, Drejtuese për Kanalet Alternative dhe Marketingun Digjital, mbajti një leksion të hapur me 100 studentë nga fakulteti i ekonomisë dhe inxhinierisë, në universitetin Epoka mbi temën "Rinia dhe bankingun digjital".
- Në datën 25 mars, z. Reglend Xhango dhe znj. Renalda Kushe, Departamenti i Sigurisë dhe Menaxhimit të Vazhdueshmërisë së Operacioneve (NVB), organizuan orë të hapur mësimore me pjesëmarrjen e 70 nxënësve të klasave të katërta dhe të pesta në mjediset e "Albanian College", Tiranë.



- Në Ditën Botërore të Sindromës Down, 21 mars, Raiffeisen Bank mbështeti fushatën "Çorapet e Shumta Shumëngjyrëshe", e cila ka për qëllim rritjen e ndërgjegjësimit dhe mbledhje e fondeve për ofrimin e shërbimeve terapeutike për fëmijët me sindromën Down pranë "Fondacionit Down Syndrome Albania". Gjithashtu, në mbështetje të kësaj kauze u organizua edhe një marshim simbolik "Buddy Walk® Tirana-

Eja të kesh një shok për kokë" më 20 Mars.

- Në datat 23- 24 shkurt, pjesë e Panairit të punës Syn+Ergasia pranë Pallatit të Kongreseve.
- Zëri mund të shkojë atje ku shikimi nuk mundet! Banka u rikthye në "Institutin e nxënësve që nuk shikojnë" për të filluar iniciativën vullnetare "Dhuruesit e zërit" në ndihmë të 12 mijë njerëzve që nuk shikojnë. Për gjatë gjithë vitit një pjesë e stafit të Raiffeisen do të lexojnë nga një libër, për t'u bërë pjesë e librarisë në audio për njerëzit që nuk mund të lexojnë me sy të lirë.
- Raiffeisen Bank përuroi ambientet e reja të degës së saj në qytetin e Korçës, duke shënuar investimin e parë të rëndësishëm të këtij viti në rrjetin e saj të degëve. Tashmë bizneset dhe klientët individë në qytetin e Korçës do të mirëprehen në një ambient me kushte dhe standarde të larta bashkëkohore. Më shumë hapësirë për klientët, organizim me efikas i shërbimit, shërbim Wi-Fi brenda njësisë, si edhe përmirësimi i infrastrukturës janë disa nga përfitimet e sjella nga transformimi i degës sipas standardit të ri. Në ceremoninë e inaugurimit morën pjesë Drejtori i Përgjithshëm i Raiffeisen Bank Shqipëri, z. Christian Canacaris, Kryetari i Bashkisë Korçë, z. Sotiraq Filo, përfaqësues të Bordit Drejtues të Raiffeisen Bank Shqipëri, si dhe përfaqësues të institucioneve lokale dhe bizneseve në qytetin e Korçës, etj.
- Në të gjithë rrjetin e degëve



Raiffeisen Bank çdo klient do ketë të mundur përdorimin e shërbimit WiFi. Kjo iniciative u realizua në kuadër të digjitalizimit të proceseve bankare. Nëpërmjet këtij shërbimi çdo klient mund të shkarkojë platformën Raiffeisen ON për një përvojë bankare me të shpejtë apo aplikacionin My Raiffeisen për të çelur llogarinë online.

- Gjatë gjithë muajit Mars si pjesë e programit “RBAL Wellness” u organizuan disa aktivitete me ekspertë të fushave të ndryshme. Tematikat kanë qenë rreth shëndetit fizik të gruas duke marrë shkas nga Dita Ndërkombëtare e Gruas.

- Në kuadër të Javës së Parasë:

- » Raiffeisen Bank mbështeti konkursin “Sfida e Javës: 7 pyetje mbi paranë dhe bankat” organizuar nga Banka e Shqipërisë dhe Shoqata Shqiptare e Bankave. Çmimet fituese për pesë gjimnazistët e këtij konkursi u dorëzuan nga zj. Vilma Baçe Anëtare e Bordit Drejtues për Biznesin Retail pranë Raiffeisen Bank.

- » Më datë 24 mars stafi i Raiffeisen mbajti një leksion të hapur për studentet e Fakultetit të Shkencave të Natyrës, në Universitetin e Tiranës, me temë “Rinia & Bankingu Digjital”.



- Në kuadër të Javës së Parasë, OTP Bank Albania zhvilloi disa

aktivitete me fokus edukimin financiar:



- » Mbështeti konkursin për nxënësit e klasave IX me fotomontazhe (meme) “Tregohu i zgjuar me paranë, ndërto të ardhmen tënde!”.

- » Leksione të hapura u zhvilluan nga punonjës të Bankës OTP Albania në shkollën 9-vjeçare “Ylber” dhe në Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë, ku tema ishte mbi bankingun digjital dhe orientimin dhe përparësinë që bankat kanë drejt plotësimin të nevojave të klientëve nëpërmjet kanaleve digjitale.

- Një tjetër bashkëpunim i OTP Bank Albania shkon në mbështetje të artit. “Katrori i Pushtetit” është seriali më i ri shqiptar i dedikuar lirisë së medias dhe lirisë së shprehjes në vendin tonë. Banka OTP Albania, ofroi ndihmën e saj në realizimin e një projekti të tillë, që ngre vlerë. #RollForGreatness

- “Të zhveshur, por bashkë”, një sfaqje teatrale nga Leonard Bombaj dhe familja e tij e cila provon brenda saj dilemat, humorin dhe nostalgjinë. Një turne i cili nisi në datën 4 shkurt 2022 në Tiranë dhe vazhdon siparin e tij në të gjithë Shqipërinë është sponsorizimi i radhës i Bankës OTP Albania nën sloganin #CultureforGreatness.

- Edhe këtë vit vazhdojmë të japim kontributin tonë për “Partizani Basket” duke promovuar kështu një jetesë të shëndetshme, sepse aktiviteti tek të rinjtë dhe të rriturit është tepër i domosdoshëm. Një



bashkëpunim i frytshëm midis OTP Bank dhe Partizani Basket bëri që objektivat e skuadrës në vitin 2020-2021 të arriheshin.

- Në datën 17 shkurt, 2022 FIAA organizoi eventin Energy, Oil and Gas, Infrastructure, Telecommunications – Sustainable Development in Albania. Në këtë event ishin pjesëmarrës anëtarët e FIAA, diplomatë të ndryshëm në Shqipëri dhe Ministrija e Infrastrukturës dhe Energjetikës, znj. Belinda Balluku. Banka OTP Albania mbështeti këtë aktivitet për të gjitha detajet teknike dhe për t'i dhënë zë zhvillimit të qëndrueshëm.



- Banka ProCredit ka qenë e ftuar për të dytin vit radhazi në Konferencën Think Tech. Përfaqësuesja e bankës znj. Belma Lushi mbajti një prezantim në lidhje me digjitalizimin dhe sigurinë e të dhënave të klientëve.
- Promovimi i makinave elektrike si një mjet transporti i cili sjell shumë përfitime si për përdoruesit, ashtu edhe për mjedisin, është një nga iniciativat në fokus të bankës. Banka ka nisur një fushatë e cila synon të informojë në lidhje me kushtet preferenciale për makina elektrike, si dhe avantazhet e makinave në reduktimin e ndotjes. Pjesëmarrja e përfaqësuesve të bankës në disa emisione televizive kanë pasur

qëllim informimin në lidhje me këto mjeteve ekologjike.

- Lancoi aplikacionin “ProCredit Electric Stations”, i cili mund të shkarkohet në telefon dhe ofron orientim për stacionin me të afërt elektrik ku mund karikohet makina elektrike.
- Banka morri pjesë në Panairin e Punës Syn+Ergasia, zhvilluar në Tiranë.
- ProCredit Bank ofron mbështetje në investimet eco në biznes, si: Panele fotovoltaike; Linja prodhimi eficiente; Makina elektrike, etj. Nxitja e këtyre investimeve ka qenë në fokus të fushatës më të re për SME-të, që janë dhe bizneset më potenciale për të siguruar rritje ekonomike dhe zhvillim të qëndrueshëm.



TIRANA BANK

- Në 8 Mars punonjëset e Tirana Bank kaluan një pasdite përtej ambienteve të zyrës, duke ndjekur në teatër premierën “Rrëfimet Tona - Gra të lira”. Kjo shfaqje ishte pjesë e festivalit të shfaqjeve teatrale “FemFest”, në datat 5-8 mars. Të ardhurat e gjeneruara nga shitja e biletave shkuan në favor të shkollimit të 4 vajzave, të cilat e kishin të pamundur përballimin e kostove për të ndjekur studimet e larta.
- Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Gruas, Tirana Bank, në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar dhe me prezencën e aktorese Roza Anagnosti, festoi me zonjat

në pamundësi ekonomike. Nën moton “Një ditë, shumë buzëqeshje” përfaqësues nga stafi bankës ishin pranë mensës së Kryqit të Kuq, ku shërbyen drekën për zonjat në nevojë.

- Tirana Bank dha kontributin e saj në rritjen e hapësirave të gjelbra në zonën e Liqenit të Paskuqanit, nën moton “Gjelbëro, Mbill, Riciklo”. Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Tirana Bank, Z. Dritan Mustafa, i pranishëm në këtë aktivitet, theksoi se Tirana Bank do të vazhdojë misionin e saj për të kontribuar në gjelbërimin e zonave të qytetit dhe jo vetëm, si një investim i zgjuar për të ardhmen e qytetit dhe shoqërisë.

UNIONBANK

- Dhuroi 600 pemë ulliri për kompleksin e banimit Mangalem 21. Ky projekt u realizua në bashkëpunim me kompaninë e ndërtimit Kontakt sh.p.k. me synimin e përbashkët për një jetë të shëndetshme në komunitet.
- Union Bank ishte pjesëmarrëse në Panairin e Punës dhe Aftësive Syn+Ergasia i organizuar në datat 23-24 shkurt.
- Aktivitetet e zhvilluara në kuadër të Javës së Parasë:
 - » Union Bank mbështeti konkursin me vizatime “Tregohu i zgjuar me paranë, ndërto të ardhmen tënde”, dhe dhuroi çmimet për 5 vizatimet fituese.
 - » Zhvilloi leksionin e hapur me

temë: “Rinia dhe Bankingu Digjital” në disa universitete:

- * Në datën 24 mars, znj. Fatbardha Rino, Drejtore e Divizionit Retail, dhe znj. Anisa Xhaxhiu, Drejtuese e Njesisë së Segmentimit dhe Eksperiencës së Klientit, në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Tiranës.
- * Në datë 25 mars 2022 në Fakultetin Ekonomik të Universitetit “Aleksandër Xhuvani” në Elbasan. Leksioni u mbajt nga z. Besnik Ranxha, Drejtor i Degës Union Bank në Elbasan.
- * Në datën 30 mars, z. Fation Ademi, Drejtor i Degës Union Bank në Shkodër, zhvilloi takimi i radhës me studentët e Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”.



- UBA Bank ka ndërmarrë një projekt të ri të në kuadrin e edukimit financiar të publikut. Banka ka ftuar studentët e CIT dhe jo vetëm, të marrin pjesë në konkursin me temë “UBA Mobile Banking – Business Case”. Në këtë konkurs UBA Bank mirëpret propozimet dhe sugjerimet e studentëve për ide të reja në përmirësimin apo përshtatjen e këtij produkti, për të qenë më i dobishëm dhe lehtësisht i përdorshëm nga klientët dhe do të vlerësojë tre projektet më të mira.

